

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	
EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 90/2016 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës, Akredituar nga Bashkimi Evropian, në Republikën e Shqipërisë”
INSTITUCIONI UDHËHEQËSE	Kryeministria
FAZA E POLITIKËS/VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Finale
BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	I brendshëm
DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së	Jo e zbatueshme
PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA	Jo e zbatueshme
DATA E KONSULTIMIT PUBLIK	13/11/2024 – 11/12/2024
DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	28/01/2025
A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT? NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT	Po 03/11/2024
NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	2025 – AAPAA – Nr. 1
TE DHËNA KONTAKTI (EMRI, E-MAIL, NUMRI I TELEFONIT TË PERSONIT TË KONTAKTIT)	Ardit Preçi Email: ardit.preci@aapaa.gov.al , Nr. Tel: +355684818103
PJESA 1: PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	
PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT <i>Cili është problemi në shqyrtim dhe cilat janë shkaqet e tij? Pse është e nevojshme ndërhyrja qeverisë?</i>	
Bazuar në misionin dhe fushën e veprimtarisë së Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës, e akredituar nga Bashkimi Evropian, për të siguruar verifikimin e efektivitetit dhe funksionimit të duhur të sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit të fondeve të BE-së në Shqipëri, janë identifikuar probleme në organizimin e brendshëm të Agjencisë. Problematikat në shqyrtim po i parashtrojmë si me poshte vijon:	
1. Mbivendosja e kompetencave: - Ekzistenca e dy strukturave përgjegjëse për auditimin e fondeve IPA (Drejtori i Përgjithshëm dhe Këshilli Mbikëqyrës) krijon mungesë qartësie dhe efektiviteti në zbatimin e detyrave. - Ky konflikt bie në kundërshtim me Marrëveshjen Kuadër IPA dhe standardet ndërkombëtare të auditimit, duke penguar ndarjen e qartë të roleve dhe përgjegjësi.	

2. Përputhshmëria e kufizuar me standardet e BE-së dhe rregullat kombëtare:

- Organizimi i brendshëm i Agjencisë nuk përmbush standardet e BE-së dhe kërkesat ligjore kombëtare, duke cënuar përputhshmërinë dhe efektivitetin e auditimeve.

3. Mangësi ligjore në procesin e emërimit të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës:

- Nuk ka qartësi mbi kriteret, procedurat dhe autoritetin përgjegjës për emërimin e anëtarëve të Këshillit, duke krijuar paqartësi dhe vendimmarrje të paqëndrueshme.

4. Rreziku për objektivat institucionale dhe akreditimin:

- Këto mangësi rrezikojnë përmbushjen e objektive të Agjencisë dhe akreditimin nga BE-ja, çka mund të ndikojë negativisht në marrëdhëniet e Shqipërisë me BE-në dhe në mbështetjen financiare të ardhshme.

5. Mungesa e harmonizimit ligjor dhe standardizimit:

- Përkufizimet dhe termat në ligjin aktual janë të paqartë dhe të papërputhur me standardet e BE-së, duke krijuar hapësirë për interpretime të ndryshme dhe zbatim të pasaktë të detyrave.

Shkaqet e problematikave të evidentuara më lart janë:

- Konflikt i brendshëm midis strukturave organizative për shkak të paqartësive ligjore dhe mbivendosjes së kompetencave.
- Dispozitat ligjore aktuale që nuk i përshtaten standardeve ndërkombëtare të auditimit dhe Marrëveshjes Kuadër IPA.
- Mungesa e një metodologjie të qartë për emërimin dhe përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës.

Grupet e prekura nga problematikat:

1. Agjencia e Auditimit të Programeve të Asistencës së Akredituar (AAPAA);
2. Këshilli Mbikëqyrës i AAPAA-së;
3. Komisioni Evropian dhe DG NEAR;
4. Grupet e interesit përfituese nga fondet IPA;
5. Shoqëria civile dhe qytetarët shqiptarë;
6. Institucionet e tjera shtetërore.

Në përmbledhje të sa më sipër, problemi qëndron në organizimin e brendshëm dhe dispozitat ligjore që nuk përputhen me standardet ndërkombëtare dhe Marrëveshjen Kuadër IPA, duke ndikuar negativisht në efikasitetin e Agjencisë dhe marrëdhëniet e Shqipërisë me BE-në. Zgjidhja kërkon një rishikim të strukturave organizative, ndarjen e qartë të kompetencave dhe harmonizimin e dispozitave ligjore me standardet e BE-së.

Sa më sipër synohet një ndërhyrje e përshtatshme/efektive e cila të garantojë që Agjencia të ketë mandatin dhe lirinë për të kryer funksionet e saj sipas kërkesave të Marrëveshjes Kuadër IPA, marrëveshjeve të tjera sektoriale dhe/ose financuese duke rritur pavarësinë funksionale dhe financiare.

Arsyet kryesore të ndërhyrjes po i rendisim si më poshtë vijon:

1. Përmirësimi i efikasitetit dhe efektivitetit të Agjencisë;
2. Përshtatja me marrëveshjet kuadër IPA dhe standardet ndërkombëtare të auditimit;
3. Forcimi i pavarësisë dhe transparencës së AAPAA-së;
4. Qartësimi i procedurave për emërimin dhe kompetencat e Këshillit Mbikëqyrës;
5. Rishikimi dhe standardizimi i përkufizimeve dhe terminologjisë ligjore.

OBJEKTIVAT

Cilat janë objektivat dhe efektet e synuara të propozimit?

- Qartësimi i kompetencave dhe përgjegjësi brenda strukturës së AAPAA-së, brenda vitit 2025;
2. Përmirësimi i efikasitetit operacional të Agjencisë, brenda vitit 2025;
 3. Standardizimi i funksionimit të strukturave audituese në të gjitha procese;
 4. Harmonizimi i kuadrit rregullator të AAPAA-së me marrëveshjet dhe standardet ndërkombëtare;
 5. Forcimi i sistemit të menaxhimit dhe kontrollit të fondeve të BE-së;
 6. Rritja e transparencës dhe llogaridhënies;
 7. Sigurimi i një strukturë drejtuese funksionale që siguron përmbushjen e misionit dhe objektivave të AAPAA-së, brenda vitit 2025

OPSIONET E POLITIKAVE

Cilat janë opsionet kryesore të politikave, duke përfshirë mënyrat ndaj rregullimit? Duhet të bëni krahasimin e avantazheve/përfitimeve kryesore dhe të dizavantazheve/kostove të opsioneve të mundshme. Duhet të përcaktoni detajet në lidhje me opsionin e preferuar.

Për arritjen e objektivave të politikës janë shqyrtuar opsionet e mëposhtme:

1. Opsioni 0 - Ruajtja e status quo-së:

Me këtë opsion, ruajtja e status quo-së, nuk ndërmerret asnjë ndryshim në kuadrin ligjor aktual, duke vazhduar me ligjin ekzistues për organizimin dhe funksionimin e AAPAA-s. Ky opsion nuk kërkon kosto shtesë apo burime njerëzore të reja, por nuk arrin të adresojë problematikat ekzistuese organizative dhe funksionale të Agjencisë. Për më tepër, kjo qasje nuk mundëson përmbushjen e objektivave të parashikuara.

2. Opsioni 1 (jorregullator) - Përdorimi i marrëveshjeve mirëkuptimi dhe udhëzimeve të brendshme:

Opsioni 1 parashikon përdorimin e marrëveshjeve mirëkuptimi (MoU) dhe udhëzimeve të brendshme për të zgjidhur problematikat pa nevojën për ndryshime ligjore. Ky opsion është më i shpejtë dhe më pak i kushtueshëm, duke rritur bashkëpunimin ndërinstitucional përmes përcaktimit

të detyrave dhe përgjegjësi. Megjithatë, ai nuk ofron garanci të detyrueshmërisë dhe mund të jetë i pamjaftueshëm për adresimin e çështjeve më komplekse.

3. Opsioni 2- Hartimi i një ligji të ri:

Opsioni 2 sugjeron hartimin e një ligji të ri, që do të krijonte një kuadër të përditësuar dhe gjithëpërfshirës në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit dhe Marrëveshjen Kuadër IPA. Ky opsion do të zgjidhte të gjitha problematikat ekzistuese në mënyrë afatgjatë, por procesi i hartimit dhe miratimit të një ligji të ri kërkon kohë të gjatë dhe kosto të lartë. Për më tepër, shkalla e ndryshimeve aktuale nuk justifikon hartimin e një kuadri tërësisht të ri.

4. Opsioni 3- Ndryshimi i ligjit ekzistues (opsioni i preferuar):

Opsioni i preferuar, ndryshimi i ligjit ekzistues, ofron një zgjidhje më të shpejtë dhe efektive. Ky opsion harmonizon kuadrin ligjor të AAPAA-së me Marrëveshjen Kuadër IPA dhe standardet ndërkombëtare, duke rritur qartësinë ligjore, efektivitetin dhe pavarësinë institucionale të Agjencisë. Ndryshimet e propozuara adresojnë problematikat aktuale me kosto më të ulët dhe proces më të shpejtë krahasuar me hartimin e një ligji të ri, duke përmirësuar strukturën dhe funksionimin e Agjencisë në përputhje me zhvillimet më të fundit.

ANALIZA E NDIKIMEVE

Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar? Kjo duhet të përfshijë ndikimet me vlerë monetare të përcaktuar dhe ndikimet pa vlerë monetare të përcaktuar mbi buxhetin dhe bizneset.

Ndryshimet e propozuara rrisin efikasitetin dhe transparencën e funksionimit të AAPAA-së, duke përfutur të gjithë aktorët e përfshirë, nga stafi i brendshëm deri te përfituesit finalë të fondeve IPA. Ndikimet financiare dhe sociale afatshkurtra mund të jenë sfiduese, por ndikimet pozitive afatgjata i tejkalojnë ato.

Në mënyrë të përmbledhur, po paraqesim grupet e prekura nga kjo politike dhe disa prej ndikimeve kryesore të evidentuara:

Grupet e prekura

1. AAPAA dhe stafi i saj: Ndryshimet ligjore ndikojnë drejtpërdrejt te mënyra e organizimit, ndarja e kompetencave dhe funksionaliteti i strukturave, si Drejtori i Përgjithshëm dhe Këshilli Mbikëqyrës.
2. Këshilli Mbikëqyrës i AAPAA-së: Ndikohen nga ndryshimet në kompetenca dhe procedurat e emërimit, duke përmirësuar qartësinë ligjore dhe llogaridhënien.
3. Komisioni Evropian dhe DG NEAR: Si institucione monitoruese për fondet IPA, këto organe mbështeten në një funksionim të qartë dhe të përmirësuar të AAPAA-së.
4. Grupet e interesit që përfitojnë nga fondet IPA: OJQ-të, bizneset dhe individët do të përfitojnë nga menaxhimi më efikas i fondeve.
5. Shoqëria civile dhe qytetarët shqiptarë: Përmirësimi i transparencës dhe efikasitetit ndikon pozitivisht në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror.
6. Institucionet shtetërore: Bashkëpunimi me AAPAA-në bëhet më efikas për shkak të qartësisë së re në kompetenca dhe procedura.

Ndikimet sociale

- Pozitive:
 - Qartësimi i përgjegjësi dhe procedurave rrit drejtësinë dhe transparencën.
 - Besimi publik tek institucionet shtohet për shkak të një kuadri ligjor më të qartë dhe funksional.
- Negative:
 - Aktorët ekzistues mund të ndihen të kërcënuar nga ndryshimet që prekin pozitën dhe proceset aktuale.

Ndikimet ekonomike

- Pozitive:
 - Rritet efikasiteti dhe efektiviteti në menaxhimin e fondeve IPA.
 - Harmonizimi me standardet ndërkombëtare rrit mundësitë për financime të reja nga BE.
- Negative:
 - Kërkohen kosto fillestare për trajnime dhe përshtatje me rregullat e reja.
 - Procedurat komplekse mund të krijojnë sfida për përfituesit fillestarë.

Ndikimet financiare

- Pozitive:
 - Alokim më i mirë i burimeve financiare dhe rritje e potencialit për financime të reja.
- Negative:
 - Kosto fillestare për implementimin e ndryshimeve, përfshirë trajnimin dhe përshtatjen e procedurave.

ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR

Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opsionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare.

Opsioni 3, i cili konsiston në ndryshimin e ligjit ekzistues për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës të Akredituar nga BE (AAPAA), është vlerësuar si më i miri dhe më i përshtatshmi. Kjo qasje adreson objektivat e parashikuara duke harmonizuar kuadrin ligjor të brendshëm me Marrëveshjet Kuadër IPA dhe standardet ndërkombëtare të auditimit, si dhe duke rritur pavarësinë funksionale dhe financiare të Agjencisë.

Risite e ndryshimit të ligjit po i rendisim më poshtë:

1. Forcimi i strukturave audituese.
Përmirëson standardizimin dhe funksionimin sipas praktikave më të mira ndërkombëtare dhe rekomandimeve të BE-së.
2. Ndarje e qartë e kompetencave.
Qartësohen rolet e Drejtorit të Përgjithshëm dhe Këshillit Mbikëqyrës për të shmangur mbivendosjet dhe për të rritur efikasitetin.
3. Përditësimi i përkufizimeve dhe terminologjisë.
Siguron përputhje me Marrëveshjet Kuadër IPA dhe standardet ndërkombëtare.
4. Rritja e pavarësisë dhe transparencës.

Siguron që Agjencia të ketë liri dhe autonomi për të përmbushur funksionet e saj sipas kërkesave të BE-së.

5. Standardizimi i procedurave.

Përmirëson konsistencën në emërimin dhe funksionimin e Këshillit Mbikëqyrës duke përcaktuar kritere transparente dhe të qarta.

6. Efikasitet në procesin legjislativ.

Ndryshimet prekin më pak se 50% të dispozitave të ligjit, duke mundësuar një miratim dhe zbatim më të shpejtë.

Bazuar në risitë e evidentuara më lart ky projektligj do të mundësojë:

- Përmirësimin e menaxhimit dhe vendimmarrjes për auditimin e fondeve të BE-së.
- Rritjen e transparencës dhe besueshmërisë së Agjencisë në menaxhimin e fondeve publike.
- Harmonizimin e kuadrit ligjor me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare për auditimin dhe menaxhimin financiar.

Kostoja e përlogaritur në total e opsionit të preferuar mbi buxhetin e shtetit gjatë periudhës 3-vjeçare menjëherë pas miratimit të ligjit (kostoja në total në lek, çmimet aktuale, në terma nominalë):

Viti <u>1</u>	Viti <u>2</u>	Viti <u>3</u>
Nuk aplikohet	Nuk aplikohet	Nuk aplikohet

KONSULTIMI

Ky projektligj është publikuar në regjistrin elektronik për njoftim dhe konsultim publik në datë 13.11.2024 dhe ka përfunduar periudha e publikimit të tij më datë 11.12.2024, në respektim të afatit të përcaktuar në ligjin nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”. Nuk ka patur komente për këtë projektligj nga grupet e interesit dhe numri i shikimeve ka qënë 242 (dyqind e dyzet e dy).

ZBATIMI DHE MONITORIMI

Strukturat përgjegjëse në AAPAA përfshijnë Drejtorinë e Auditimit të Programeve IPA dhe Drejtorinë e Auditimit të Programeve IPARD. Këto drejtori janë përgjegjëse për auditimin e fondeve IPA dhe IPARD, duke verifikuar efektivitetin dhe funksionimin e mirë të sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit të fondeve të BE-së në Shqipëri, në përputhje me rregullat përkatëse të BE-së dhe ato kombëtare, për të siguruar ligjshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve.

Pas miratimit të projektligjit, do të miratohet një Vendim i Këshillit të Ministrave (VKM) që do të rregullojë detajet e veprimtarisë së Këshillit Mbikëqyrës të AAPAA, si dhe procedurat për emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të tij. Gjithashtu, do të miratohet Rregullorja e Brendshme e AAPAA. Masa për zbatimin e projektligjit përfshijnë përgatitjen e dokumenteve strategjike dhe shkëmbimin e të dhënave midis strukturave përgjegjëse dhe zbatuese. Për më tepër, do të organizohen takime

periodike ndërinstytucionale për të monitoruar progresin dhe për të përcaktuar qartë detyrat dhe përgjegjësitë e secilës strukturë përmes planeve të veprimit.

Monitorimi i zbatimit të projektligjit kryhet nga Komisioni Evropian përmes DG NEAR dhe nga qeveria shqiptare përmes raportimeve periodike në Kryeministri. Strategjitë dhe raportet vjetore të auditimit dërgohen njëkohësisht Komisionit Evropian dhe Këshillit të Ministrave, duke përmbushur kërkesat e Marrëveshjeve Kuadër IPA dhe standardeve ndërkombëtare të auditimit.

Ndryshimet ligjore pritet të forcojnë funksionimin e AAPAA-së, duke e bërë më efektive dhe efikente në arritjen e objektivave institucionale brenda afateve dhe standardeve të përcaktuara.

PJESA 2: BAZA KRYESORE E ANALIZËS DHE E PROVAVE

Historik

Jepni kontekstin e politikës.

Agjencia e Auditimit të Programeve të Asistencës Akredituar nga Bashkimi Evropian u krijua në vitin 2009, nëpërmjet Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.1020, datë 14.10.2009 “Për Krijimin e Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës, Akredituar nga Bashkimi Evropian”, si një institucion publik buxhetor, në varësi të Ministrit të Financave, i cili është zyrtari përgjegjës akreditues (ZPA/CAO) sipas Marrëveshjes Kuadër IPA 2007-2013.

Por duke qënë se Agjencia ka objektiv të veprimtarisë auditimin dhe kontrollin e zbatimit të programeve të asistencës, akredituar nga Bashkimi Evropian Republikës së Shqipërisë, bazuar në detyrimet ndërkombëtare, si dhe funksionalisht e pavarur nga të gjithë aktorët në sistemin e menaxhimit të decentralizuar të asistencës, së akredituar nga BE-ja, si dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare të pranuar, lindi nevoja e kryerjes së ndryshimeve organizative, strukturore dhe mbikqyrëse duke u bazuar edhe në Ligjin Nr. 90/2012 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore”.

Në këtë mënyrë në shtator 2016 u miratua Ligji Nr. 90/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Auditimit për Programet e Asistencës së Akredituar të BE-së në Republikën e Shqipërisë”, i cili ka si object përcaktimin e rregullave të organizimit e të funksionimit, detyrat dhe kompetencat e Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës, akredituar nga Bashkimi Evropian, më poshtë Agjencia.

Bazuar në këtë ligj, Agjencia ka si objekt të veprimtarisë auditimin për sistemet e menaxhimit dhe kontrollit për veprimet, transaksionet dhe llogaritë vjetore të mbështetjes financiare të Bashkimit Evropian, për fondet para dhe pas anëtarësimit. Agjencia është person juridik publik, buxhetor, i organizuar në formën e agjencisë autonome, nën mbikëqyrjen e Kryeministrit. Agjencia vepron në përputhje me kërkesat e marrëveshjeve kuadër IPA dhe marrëveshjeve të tjera sektoriale dhe / ose financuese të nënshkruara sipas marrëveshjeve kuadër.

Duke qënë se AAPAA ka në mision verifikimin e efektivitetit dhe funksionimit të mirë të sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit të fondeve të BE-së në Shqipëri, për përputhshmërinë me rregullat përkatëse të BE-së dhe rregullave kombëtare për të siguruar ligjshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve, raporton për veprimtarinë e saj pranë Komisionit Evropian sipas rregullave të përcaktuara në legjislacion dhe në marrëveshjet kuadër.

Në vitin 2022, Agjenca e Auditimit të Programeve të Asistencës Akredituar nga BE, procedoi me ndryshimin e strukturës organizative, në shtimin e stafit audites, respektivisht me Vendimi Nr. 665, Datë

19.10.2022, Për disa ndryshime në vendimin Nr. 639, Datë 6.11.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për Miratimin e Strukturës dhe të Organikës së Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës, Akredituar nga Bashkimi Evropian, në Republikën e Shqipërisë”.

Ky ndryshim ishte i nevojshëm dhe u bazua në shtimin e thirrjeve për Programin IPARD, mbështetur në rekomandimin e Progres Raportit të Komisionit Evropian (Brussels, 06.10.2020 SED (2020) 354 final) kapitulli 22, nga miratimi i programit IPARD III 2021-2027 sipas “Vendimit të Komisionit Evropian datë 09.03.2022 për miratimin e programit IPA III të Zhvillimit Rural (IPARD III) të Republikës së Shqipërisë për vitet 2021-2027”, i cili rezultonte në vlerën (56%) më shumë se buxheti i vënë në dispozicion në Programin IPARD II.

Buxheti IPARD III përpos 4 (katër) masave ekzistuese të investimeve financonte dhe 5 (pesë) masa të reja në këtë fushë, e cila sjell një rritje të intensitetit/ fluksit të punës në Drejtorinë e Programeve IPARD në AAPAA.

Sa më sipër përmbushja e kushteve të përcaktuar në nenin 154(4), nënparagrafi i parë, pikat (a) deri (f), të Rregullores (BE, Euratom) 2018/1046, bëhej një faktor i rëndësishëm që AAPAA të funksionojë sipas standardeve të Akredituar nga BE duke ngritur strukturat e përmendura në nenin 8 të kësaj rregulloreje, në mënyrë funksionimin e një sistemi efektiv dhe efikas të kontrollit të brendshëm të bazuar në praktikat më të mira ndërkombëtare.

Në funksion të ndryshimeve të propozuara, në vijim listohen gjetjet dhe direktivat e ardhura nga Departamenti i Politikave të Zgjerimit në Komisionin Evropian (DG NEAR) të përcjella nga organet përgjegjëse të Bashkimit Evropian me dokumentat rekomandues dhe komentues të ligjit të brendshëm të organizimit dhe funksionimit të Agjencisë së Auditimit nëpërmjet raporteve zyrtare:

- Raporti final i gjetjeve dhe rekomandimeve për Republikën e Shqipërisë nga DG NEAR Ref.Ares (2024)398249 - 18/01/2024 (Subject: Review of the request of the Republic of Albania for the Entrustment of Budget Implementation Tasks under IPA III), ku kërkohet ndryshimi i ligjit nr. 90/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës, akredituar nga Bashkimi Evropian, në Republikën e Shqipërisë”, në mënyrë që të qartësohen kompetencat midis Këshillit Mbikqyrës dhe drejtorit të përgjithshëm. Drejtori i përgjithshëm duhet të jetë përgjegjës sipas përcaktimeve në përputhje me marrëveshjet kuadër IPA II dhe IPA III. Në kuadër të auditimit të fondeve IPA, Këshilli Mbikqyrës nuk mund të ketë kompetencat e organit drejtues të Agjencisë, por mund të ushtrojë detyra mbikëqyrëse, të cilat nuk bien ndesh me marrëveshjen kuadër.
- Raporti i gjetjeve dhe rekomandimeve për Republikën e Shqipërisë nga DG NEAR, Ref.Ares(2023)4949695 - 17/07/2023, ku cilësohet se Shqipëria duhet të procedojë me miratimin e ndryshimeve të ligjit për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Auditimit për Programet e Asistencës, akredituar nga BE, në Republikën e Shqipërisë.
- Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë, Strasbourg, 19.10.2021 SWD (2021) 289 final; kapitulli 22 “Politikat rajonale dhe koordinimi i instrumenteve strukturore”, në lidhje me ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Auditimit, Akredituar nga Bashkimi Evropian në Republikën e Shqipërisë”, në kuadër të menaxhimit financiar, kontrollit dhe auditimit.
- Rekomandimi në SYS-DR/2020/04/AL Inventory of findings and recommendations IPA II - Annual Action Programmes Republic of Albania, sipas të cilit:
- “...si prioritet, Shqipëria duhet të ndryshojë ligjin nr.90/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës, akredituar nga Bashkimi Evropian, në Republikën e Shqipërisë ... ”.

- Ligji i Agjencisë së Auditimit duhet të përputhet me dispozitat e marrëveshjes kuadër, sipas të cilave Komisioni Evropian nuk jep opinione mbi programet vjetore dhe strategjike të punës përpara se të jenë miratuar nga drejtori i përgjithshëm.
- Shkresa e DG NEAR Ref. NEAR R.3/NS — ARES (2018) 6221182 “Law on the Audit Authority”;
- Ref. Ares (2020)1966871 - 07/04/2020 SYS/2019/04/AL Inventory of findings and recommendations IPA II - Annual Action programmes Republic of Albania;
- Ref. SYS/2018/02/AL- Final Inventory of Findings and Recommendations - AL CAP 2014, 2015 & 2017 Mission: 05-08/06/2018 Draft report 31/10/2018 Response: 24/01/2019 Final report: 16/04/2019 – Ares (2019)2649845;
- Ref. Ares (2020)2546888-14/05/2020 të D-Western Balkans Neighbourhood and Enlargement Negotiations, European Commission, përcjellë me shkresën Ref. Ares (2020) 2553399.

Problemi në shqyrtim

- *Përshkruani natyrën e problemit.*
- *Identifikoni shkaqet e problemit.*
- *Përshkruani shtrirjen e problemit.*
- *Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria / biznesi / shoqëria civile / qytetarët.*
- *Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave.*

Bazuar në misionin dhe fushën e veprimtarisë së Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës, e akredituar nga Bashkimi Evropian, për të siguruar verifikimin e efektivitetit dhe funksionimit të duhur të sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit të fondeve të BE-së në Shqipëri, janë identifikuar probleme në organizimin e brendshëm të Agjencisë. Këto probleme janë në kundërshtim me përcaktimet e Marrëveshjes Kuadër IPA dhe pengojnë arritjen e objektivave institucionale, pasi ekzistenca e dy strukturave përgjegjëse me kompetenca të mbivendosura për auditimin e fondeve IPA është në kundërshtim me kërkesat dhe standardet e përcaktuara në këtë marrëveshje. Problematikat e identifikuara po i analizojmë si me poshte vijon:

Përputhshmëria me standardet e BE-së dhe rregullat kombëtare:

Agjencia e Auditimit është përgjegjëse për të siguruar që menaxhimi dhe kontrolli i fondeve IPA në Shqipëri të përputhen me standardet e BE-së dhe rregullat kombëtare. Problemet e raportuara tregojnë se organizimi i brendshëm aktual nuk e përmbush këtë kërkesë.

Mbivendosja e kompetencave:

Ekzistenca e dy strukturave me përgjegjësi të ngjashme për auditimin e fondeve IPA krijon konfuzion dhe mungesë qartësie në zbatimin e detyrave. Kjo situatë bie në kundërshtim me Marrëveshjen Kuadër IPA, e cila kërkon ndarje të qartë të roleve dhe përgjegjësisë për menaxhimin dhe kontrollin e fondeve IPA, për të siguruar efektivitetin e auditimit.

Ndikimi në objektivat institucionale:

Problemet në organizimin e brendshëm të Agjencisë pengojnë përmbushjen e objektivave institucionale, veçanërisht lidhur me garantimin e ligjshmërisë dhe rregullsisë së transaksioneve. Ky mosfunksionim rrezikon besueshmërinë e Shqipërisë në menaxhimin e fondeve IPA, një aspekt thelbësor për marrëdhëniet me BE-në dhe për mbështetjen financiare të ardhshme. Pa një zgjidhje të problemit, ekziston rreziku i refuzimit të akreditimit nga BE-ja ose e reduktimit të mbështetjes financiare. Një

organizim joefikas dëmton transparencën dhe përgjegjshmërinë e Agjencisë, pasi ligji nr. 90/2016 aktualisht i jep Këshillit Mbikëqyrës disa kompetenca, që lidhen drejtpërdrejt me planifikimin e auditimeve, duke krijuar mbivendosje me funksionet e Drejtorit të Përgjithshëm të AAPAA.

Sipas standardeve ndërkombëtare të auditimit, procesi i auditimit duhet të jetë i qartë dhe i ndarë, që nga planifikimi deri në përfundim të tij dhe kompetencat audituese duhet të jenë të qarta dhe të përqendruara te drejtuesi i Agjencisë. Në përputhje me marrëveshjet kuadër, drejtori i përgjithshëm i Agjencisë së Auditimit, të ketë kompetencat e hartimit dhe miratimit të Strategjisë së Auditimit, raporteve vjetore të aktivitetit të auditimit, si dhe opinioneve vjetore të auditimit. Drejtori i përgjithshëm përcakton metodologjinë, metodat e përzgjedhjes që do të zbatohen për auditimet, si dhe për planifikimin e auditimeve. Këshilli Mbikëqyrës mund të ushtrojë, detyra të mbikëqyrjes, të cilat nuk duhet të bien në kundërshtim me dispozitat e marrëveshjeve kuadër, për sa i përket autoritetit të auditimit, duke i hequr në këtë mënyrë kompetencat e miratimit të programeve vjetore dhe strategjike të auditimit. Në ligjin aktual, fuqia vendimmarrëse mbi dokumentet strategjike dhe planifikimin e auditimeve i takon Këshillit Mbikëqyrës, duke kufizuar rolin e Drejtorit të Përgjithshëm në ushtrimin e funksioneve të tij kryesore.

Mangësi në ligjin aktual sa i takon procesit të emërimit të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës:

Mungesa e qartësisë në mënyrën e emërimit dhe kriteret për anëtarët e Këshillit krijon paqartësi dhe mundësi për vendimmarrje të paqëndrueshme. Prosesi i emërimit të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës nuk është i përcaktuar qartë, pasi nuk përcaktohet autoriteti përgjegjës për emërimin e tyre dhe mungojnë kriteret të mirëstrukturuara për përzgjedhjen e tyre. Kjo mungesë mund të ndikojë negativisht në besueshmërinë dhe funksionimin e Agjencisë.

Rrjedhojat institucionale si pasojë e mbivendosjes së kompetencave: Strukturat aktuale të përcaktuara në ligj pengojnë përmbushjen e misionit të Agjencisë dhe zbatimin efektiv të rekomandimeve të BE-së. Paqartësitë në ndarjen e kompetencave dhe mungesa e standardizimit në proceset e emërimit krijojnë rrezik për moszbatim të Marrëveshjes Kuadër IPA.

Mungesa e harmonizimit të përkufizimeve në ligjin aktual me standardet e BE-së.

Përkufizimet dhe termat aktuale në ligj janë të paqarta ose të papërputhur me rregullat dhe standardet ligjore ekzistuese, duke krijuar hapësirë për interpretime të ndryshme. Kjo mund të pengojë zbatimin efektiv të detyrave funksionale të Agjencisë. Standardizimi do të ndihmojë në sigurimin e koherencës ligjore dhe zbatimin e saktë të detyrave të përcaktuara në ligj.

Sa më sipër, në mënyrë të përmblodhur, mangësitë aktuale përfshijnë mbivendosje kompetencash midis Këshillit Mbikëqyrës dhe Drejtorit të Përgjithshëm, mungesë qartësie dhe transparence në mënyrën e emërimit të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës, si dhe mosrespektim të standardeve ndërkombëtare dhe praktikave më të mira të auditimit.

Këto problematika shtihen brenda territorit të Republikës së Shqipërisë për rregullat e zbatimit të mbështetjes financiare të BE-së për Shqipërinë, në kuadër të instrumentit për asistencën e paraanëtarësimit IPA, për të gjitha strukturat dhe autoritetet për menaxhimin e fondeve IPA, si dhe subjekteve përfitues të këtyre fondeve.

Grupet e prekura nga problematikat e evidentuara më lart janë:

1. Agjencia e Auditimit të Programeve të Asistencës së Akredituar (AAPAA): Si institucioni direkt i përfshirë, AAPAA preket nga ndryshimet në mënyrën e organizimit dhe ndarjes së kompetencave midis strukturave të saj, si Drejtori i Përgjithshëm dhe Këshilli Mbikëqyrës. Përcaktimi i qartë i kompetencave dhe përgjegjësi ndikon drejtpërdrejt në efikasitetin dhe funksionalitetin e Agjencisë.

2. Këshilli Mbikëqyrës i AAPAA-së: Ndryshimet në kompetencat dhe mënyrën e emërimit të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës ndikojnë te ky organ. Përcaktimi i kriterëve dhe qartësimi i rolit të Këshillit mund të ndikojnë në autoritetin dhe përgjegjësitë e tij.

3. Komisioni Evropian dhe Departamenti i Politikave të Zgjerimit (DG NEAR): Si institucione monitoruese për zbatimin e rregullave dhe standardeve të BE-së në Shqipëri, këto organe kanë interes të

drejtpërdrejtë që funksionimi i Agjencisë të jetë në përputhje me marrëveshjet kuadër IPA dhe standardet ndërkombëtare. Çdo mospërputhje mund të ndikojë në raportet dhe vlerësimet e Komisionit Evropian mbipërfomancën e Shqipërisë në menaxhimin e fondeve IPA.

4. Grupet e interesit që përfitojnë nga fondet IPA: Edhe pse ndryshimet nuk kanë ndikim të drejtpërdrejtë te këto grupe, menaxhimi i saktë dhe auditimi efektiv i fondeve garanton që ato përdoren në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme, duke siguruar përfitimin e synuar. Grupet përfshirë OJQ-të, bizneset dhe individët që përfitojnë nga asistenca financiare e BE-së, varen nga funksionimi efikas i Agjencisë për një mbikëqyrje të saktë të fondeve.

5. Shoqëria civile dhe qytetarët shqiptarë: Në mënyrë të tërthortë, përmirësimi i funksionimit të AAPAA-së rrit transparencën dhe efikasitetin në menaxhimin e fondeve publike, çka ndikon pozitivisht në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të vendit.

6. Institucionet e tjera shtetërore: Autoritetet shtetërore që bashkëpunojnë me AAPAA-në për menaxhimin dhe auditimin e fondeve mund të ndihen të ndikuara nga ndryshimet që përmirësojnë qartësinë e rolit dhe kompetencave të Agjencisë.

Çështjet e identifikuara më sipër kanë kryesisht një natyrë rregullatore, pasi ato rrjedhin nga mangësitë dhe paqartësitë në dispozitat ligjore.

Ndryshimi i politikave do të mund të trajtojë problematikat e evidentuara më lart, pasi ndërhyrjet janë kritike për të siguruar funksionimin e mirë të Agjencisë dhe për të përmbushur standardet e kërkuara nga BE-ja.

Arsyeja e ndërhyrjes

- Shpjegoni pse qeveria planifikon të ndërhyjë dhe pse është e nevojshme.
- Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje.
- Identifikoni shkallën e ndërhyrjes së qeverisë që nevojitet për të trajtuar problemin.
- Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.

Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë

Ndërhyrja e qeverisë është diktuar nga gjetjet e Komisionit Evropian për AAPAA-n dhe rekomandimet të progres raportit 2024 për Shqipërinë nga Komisioni Evropian në kontekst të ligjit “Për Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës, Akredituar nga Bashkimi Evropian, në Republikën e Shqipërisë”.

Kjo nismë duhet të ndërmerret, për të reflektuar dhe pasqyruar edhe rekomandimet dhe gjetjet e DG NEAR në lidhje me kërkesat e marrëveshjeve kuadër, marrëveshjeve të tjera sektoriale dhe/ose financuese dhe praktikën më të mira ndërkombëtare të auditimit në ligjin e brendshëm të AAPAA-s, duke forcuar kompetencat konkrete mbi mirëadministrimin dhe mbi procesin e vendimmarrjes në Agjenci.

Në përputhje me rekomandimet e DG NEAR në lidhje me kërkesat e marrëveshjeve kuadër, si dhe në referencë të raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë, në ligjin aktual shihet i nevojshëm përcaktimi i raportit midis detyrave dhe kompetencave të Këshillit Mbikqyrës dhe drejtorit të

përgjithshëm për të propozuar ndryshimet përkatëse që kompetencat e auditimit të jenë të drejtorit të përgjithshëm dhe jo të Këshillit Mbikëqyrës.

Gjithashtu, janë identifikuar nevoja në riformulime, ndryshime dhe përshtatje, në mënyrë të tillë që kuadri ligjor të jetë i përshtatshëm/efektiv, ku mos të ketë vakume për interpretim, si dhe të garantojë që Agjencia të ketë mandatin dhe lirinë e duhur për të kryer funksionet e saj.

Bazuar në gjetjet dhe rekomandimet e përmendura më lart, ndërhyrja duhet të fokusohet në:

Ristrukturimin e kompetencave të strukturave përgjegjëse. Duhet të qartësohet që kompetencat kryesore për menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditimin të mbeten te Drejtori i Përgjithshëm, duke shmangur ndërhyrjet e Këshillit Mbikëqyrës në këto fusha.

Rregullimin e procesit të emërimit të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës. Duhet domosdoshmërisht të përcaktohen qartë autoriteti përgjegjës për emërimin dhe kriteret për përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës, duke garantuar profesionalizmin dhe pavarësinë e tyre.

Rishikimin dhe përditësimin e kuadrit ligjor për të përmbushur kërkesat e Marrëveshjes Kuadër IPA dhe standardet ndërkombëtare të auditimit.

Përditësimin e formulimeve ligjore, kryesisht të përkufizimeve.

Sa më sipër synohet një ndërhyrje e përshtatshme/efektive e cila të garantojë që Agjencia të ketë mandatin dhe lirinë për të kryer funksionet e saj sipas kërkesave të Marrëveshjes Kuadër IPA, marrëveshjeve të tjera sektoriale dhe/ose financuese duke rritur pavarësinë funksionale dhe financiare.

Përmes kësaj nisme synohet:

1. Të sigurohet pavarësia funksionale e Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës, duke garantuar përputhshmërinë me detyrimet e parashikuara në Marrëveshjen Kuadër IPA dhe standardet ndërkombëtare të auditimit.
2. Të sigurohet një organizim i brendshëm i përshtatshëm, që eliminon mbivendosjen e kompetencave dhe forcon pavarësinë funksionale të Agjencisë.
3. Të sigurohet mbështetja e procesit të integritetit evropian, duke siguruar zbatimin korrekt dhe të besueshëm të instrumenteve të asistencës financiare të BE-së.

Këto ndryshime janë thelbësore për të rritur besueshmërinë e Shqipërisë në menaxhimin e fondeve të BE-së dhe për të shmangur çdo rrezik të penalizimit nga Komisioni Evropian për shkak të mosrespektimit të marrëveshjeve të ratifikuara.

Ndërhyrja është e nevojshme për disa arsye kryesore:

1. Përmirësimi i efikasitetit dhe efektivitetit të Agjencisë:

Përcaktimi i qartë i kompetencave të Drejtorit të Përgjithshëm për planifikimin dhe miratimin e strategjive dhe raporteve të auditimit, si dhe roli i Këshillit Mbikëqyrës, do të sigurojë funksionim më të koordinuar dhe më të përshtatshëm.

2. Përshtatja me marrëveshjet kuadër IPA dhe standardet ndërkombëtare të auditimit:

Marrëveshja Kuadër IPA dhe rregullat e Komisionit Evropian përcaktojnë Drejtorin e Përgjithshëm si autoritetin përgjegjës për miratimin e strategjive të auditimit dhe raporteve përkatëse. Nëse këto dispozita nuk përputhen me legjislacionin kombëtar, mund të krijohen pengesa në zbatimin e asistencës financiare të BE-së.

3. Forcimi i pavarësisë dhe transparencës së AAPAA-së:

Ndërhyrja do të garantojë pavarësinë funksionale të Drejtorit të Përgjithshëm, në përputhje me kërkesat e Komisionit Evropian. Standardizimi i proceseve do të forcojë transparencën dhe besueshmërinë e Agjencisë në menaxhimin dhe auditimin e fondeve të BE-së.

4. Qartësimi i procedurave për emërimin dhe kompetencat e Këshillit Mbikëqyrës:

Nëpërmjet kësaj nisme synohet të rregullohen këto aspekte, duke përcaktuar kritere të qarta dhe mekanizma transparentë për emërimin e anëtarëve.

5. Rishikimi dhe standardizimi i përkufizimeve dhe terminologjisë ligjore.

Atë që qeveria synon të arrijë përmes ndërhyrjes, po e paraqesim më poshtë:

1. Eliminimi i mbivendosjes së kompetencave;
2. Forcimi i kapaciteteve institucionale të AAPAA-së;
3. Përshtatja me rregullat e BE-së dhe përmbushja e objektivave IPA;
4. Sigurimi i transparencës dhe llogaridhënies;
5. Përmirësimi i procedurave të emërimit dhe kriteret për Këshillin Mbikëqyrës.

Në thelb, qeveria shpreson që me këtë ndërhyrje të krijojë një sistem auditimi më të qëndrueshëm, të pavarur dhe të përputhshëm me kërkesat ndërkombëtare, duke rritur eficiencën institucionale dhe duke mbrojtur interesin publik.

Kjo ndërhyrje mbështet objektivat e nivelit të lartë të qeverisë dhe procesin e pranimit dhe aderimit në BE, kryesisht që lidhen me ërputhshmërinë me kërkesat e BE-së. Ndërhyrja adreson gjetjet dhe rekomandimet e Komisionit Evropian dhe DG NEAR, duke siguruar përputhshmërinë e kuadrit ligjor të Agjencisë me Marrëveshjen Kuadër IPA dhe standardet ndërkombëtare të auditimit. Kjo përputhshmëri është thelbësore për të përmbushur detyrimet që rrjedhin nga procesi i integritetit evropian. Përmes këtyre ndryshimeve, qeveria siguron që strukturat shtetërore të jenë më të përshtatshme për të zbatuar në

mënyrë të efektshme dhe të besueshme detyrimet që lidhen me procesin e integritetit në BE. Kjo ndërhyrje është një hap i rëndësishëm drejt forcimit të kapaciteteve institucionale të Shqipërisë dhe përmbushjes së standardeve të kërkuara nga BE-ja.

Deri më tani ushtrimi i detyrave audituese në AAPAA është bazuar tek manuali i procedurave të Auditimit, i cili është i përgatitur nga projekti i asistencës teknike të BE në vitin 2018 për forcimet e kapaciteteve të AAPAA në përputhje me Marrëveshjet Kuadër ligjore IPA, Udhëzuesit e BE për këtë fushë dhe standardet ndërkombëtare të auditimit. Në këtë manual janë përcaktuar të gjitha hapat procedural për auditimin dhe raportimin sipas kërkesave të Komisionit Evropian.

Objektivi i politikës

- *Vendosni objektiva që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij.*
- *Sigurohuni që objektivat janë specifike, të matshme, të arritshme, realë dhe në kohë.*

1. Qartësimi i kompetencave dhe përgjegjësi brenda strukturës së AAPAA-së, brenda vitit 2025;
2. Përmirësimi i efikasitetit operacional të Agjencisë, brenda vitit 2025;
3. Standardizimi i funksionimit të strukturave audituese në të gjitha procese;
4. Harmonizimi i kuadrit rregullator të AAPAA-së me marrëveshjet dhe standardet ndërkombëtare;
5. Forcimi i sistemit të menaxhimit dhe kontrollit të fondeve të BE-së;
6. Rritja e transparencës dhe llogaridhënies;
7. Sigurimi i një strukturë drejtuese funksionale që siguron përmbushjen e misionit dhe objektivave të AAPAA-së, brenda vitit 2025

Përshkrimi i opsioneve të shqyrtuara

- *Përshkruani opsionin e status quo-së.*
- *Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që keni marrë parasysh.*
- *Shpjegoni se si janë zgjedhur opsionet e renditura.*

Për arritjen e objektivave të politikës janë shqyrtuar opsionet e mëposhtme:

Opsioni 0 (status quo): Ruajtja e status quo-së pa ndërhyrje në kuadrin ligjor ekzistues të Ligjit Nr. 90/2016 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës, Akredituar nga Bashkimi Europian, në Republikën e Shqipërisë”.

Nënkupton mosndërmarrjen e asnjë politike duke vijuar me funksionimin sipas kuadrit ligjor aktual, duke mos marrë asnjë masë për zgjidhur problematikat organizative dhe funksionale të AAPAA-s të evidentuara. Avantazhet:

1. Nuk kërkon kosto shtesë;
2. Nuk kërkon kapacitet shtesë të burimeve njerëzore;

Disavantazhet:

1. Vijimi me ligjin aktual Nuk mund të mundësojë rregullimet sipas gjetjeve dhe raporteve në kuadër të organizimit dhe funksionimit të AAPAA-s;
2. Vijimi me ligjin aktual nuk do të përmbushen objektivat e synuara;

Opsioni në fjalë nuk arrin të realizojë objektivat institucionale audituese, apo të ndajë raportet e përgjegjësisë dhe kompetencave midis Drejtorit të Përgjithshëm dhe Këshillit Mbikqyrës të AAPAA-s sepse janë problematika të brendshme në mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë, si dhe nuk ofron asnjë avantazh apo rregullimin e tyre.

Opsioni 1 (jo rregullator) –AAPAA mund të përdori marrëveshje mirëkuptimi (MoU) ose udhëzime të brendshme të detajuara, të cilat mund të ofrojnë një kornizë të qartë bashkëpunimi dhe koordinimi pa nevojën e ndryshimeve në legjislacionin ekzistues.

Marrëveshjet e Mirëkuptimit (MoU): Palët përfshihen në nënshkrimin e marrëveshjeve të cilat përcaktojnë qartë detyrimet dhe përgjegjësitë e secilës palë për përmbushjen e funksioneve të tyre.

Udhëzime të Brendshme: Hartimi i procedurave dhe standardeve të brendshme që pasqyrojnë praktikën më të mirë për zgjidhjen e problemeve dhe menaxhimin e proceseve.

Avantazhet:

1. Ky opsion nuk kërkon ndryshime të menjëhershme në ligj dhe mund të zbatohet shpejt.
2. Përcaktimi i detyrave dhe përgjegjësiave rrit bashkëpunimin ndër-institucional.
3. Kosto më e ulët: Kërkon më pak burime në krahasim me hartimin dhe miratimin e akteve rregullatore.
4. Mund të përditësohet lehtë për të reflektuar ndryshime në rrethana apo prioritete.

Disavantazhet:

1. Mungesë detyrueshmërie: Marrëveshjet dhe udhëzimet janë zakonisht vullnetare, duke u bazuar në bashkëpunimin e palëve.
2. Pa garanci për zbatim: Nuk ofrojnë të njëjtin nivel detyrueshmërie ligjore si një akt normativ.
3. Paaftësi për të adresuar çështje komplekse: Opsioni mund të mos jetë i mjaftueshëm për çështje që kërkojnë përcaktime të detajuara dhe detyrime ligjore.
4. Paaftësi për të adresuar çështje komplekse: Opsioni mund të mos jetë i mjaftueshëm për çështje që kërkojnë përcaktime të detajuara dhe detyrime ligjore.

Opsioni 2 (rregullator): - Hartimi i një ligji të ri “Për Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës, Akredituar nga Bashkimi Europian, në Republikën e Shqipërisë”. Ky opsion nuk mund të realizohet me nismën aktuale, pasi ndërhyrjet në ligj do të prekin vetëm disa nene si dhe shtohet një përkufizim i ri për të mundësuar kryerjen e detyrave institucionale sipas llojeve të auditimeve që përcaktohen në marrëveshjen kuadër IPA.

Avantazhet

1. Krijimi i një kuadri tërësisht të ri dhe të përshtatur
 - Hartimi i një ligji të ri ofron mundësinë për të ndërtuar një bazë ligjore më të plotë, të përditësuar dhe në përputhje me rekomandimet e Komisionit Evropian dhe DG NEAR.
 - Mundëson përfshirjen e të gjitha elementeve të nevojshme për harmonizimin me Marrëveshjen Kuadër IPA dhe standardet ndërkombëtare të auditimit.
2. Rregullim i plotë dhe afatgjatë
 - Një ligj i ri krijon mundësi për adresimin e të gjitha çështjeve ekzistuese dhe parandalimin e problemeve të mundshme në të ardhmen, duke siguruar një kuadër ligjor që i përshtatet zhvillimeve të reja.
3. Rritja e transparencës dhe qartësisë ligjore
 - Përkufizimet e reja dhe ndarja më e qartë e kompetencave do të shmangnin dykuptimësitë që ekzistojnë në ligjin aktual, duke rritur transparencën dhe funksionalitetin e Agjencisë.

Disavantazhet

1. Kohëzgjatja e procesit
 - Hartimi dhe miratimi i një ligji të ri kërkon një periudhë të gjatë kohe, që përfshin konsultime publike, shqyrtim parlamentar dhe aprovimin final.
 - Për zgjidhjen e problemeve urgjente dhe specifike të konstatuara, ky opsion nuk është efikas.
2. Kosto më e lartë administrative
 - Procesi i hartimit të një ligji të ri kërkon angazhim të konsiderueshëm të burimeve njerëzore dhe financiare, duke përfshirë ekspertizë të specializuar për përgatitjen dhe harmonizimin e tij me standardet ndërkombëtare.
3. Shkalla e ndryshimeve nuk justifikon një ligj të ri
 - Ndërhyrjet e propozuara prekin vetëm disa nene dhe një përkufizim të ri në ligjin aktual, gjë që nuk përbën bazë të mjaftueshme për të justifikuar hartimin e një ligji tërësisht të ri.
 - Hartimi i një ligji të ri është në disproporcion me nevojën për adresimin e çështjeve të caktuara që mund të zgjidhen me amendime në ligjin ekzistues.
4. Rreziku i zgjatjes së problematikave
 - Duke qenë se zgjidhja e problemeve të konstatuara do të vonohej deri në përfundimin e procesit, kjo mund të ndikojë negativisht në funksionimin e Agjencisë dhe përputhshmërinë me Marrëveshjen Kuadër IPA në afatin e kërkuar.

Opsioni 3: I preferuar- Ndryshimi i ligjit ekzistues 90/2016 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës, Akredituar nga Bashkimi Europian, në Republikën e Shqipërisë”. Ky opsion është vlerësuar më i miri i mundshëm preferuari për arsye që arrin objektivat e parashikuara, ndryshimin e ligjit në mënyrë të tillë që do të harmonizojë ligjin e brendshëm të AAPAA-

së me marrëveshjet kuadër IPA, si dhe do të jetë në përputhje me standardet e auditimit të pranuar ndërkombëtarisht.

Ndryshimi i ligjit është një masë e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të adresuar problemet e identifikuara. Kjo do të ofrojë një kornizë të qartë dhe të mirë përcaktuar për të gjithë aktorët në sektor, duke kontribuar në një menaxhim më të mirë të fondeve të BE-së.

Avantazhet:

1. Përshtatje me objektivat dhe standardet ndërkombëtare

- Ndryshimet do të harmonizojnë kuadrin ligjor të brendshëm të AAPAA-së me Marrëveshjet Kuadër IPA, standardet ndërkombëtare të auditimit dhe rekomandimet e Komisionit Evropian, duke forcuar pozicionin e Agjencisë në raport me BE-në.

2. Rritja e efektivitetit dhe pavarësisë institucionale

- Përmirësimet do të garantojnë që Agjencia të ketë mandatin dhe lirinë për të kryer funksionet e saj, duke rritur pavarësinë funksionale dhe financiare dhe duke mundësuar menaxhim më të mirë të fondeve të BE-së.

3. Përmirësim i qartësisë dhe përkufizimeve

- Ndryshimi i ligjit do të sigurojë që konceptet dhe përkufizimet e përdorura të jenë në përputhje me strukturën organizative të AAPAA-së, legjislacionin kombëtar dhe Marrëveshjet Kuadër IPA.

4. Proces më i shpejtë dhe më pak i kushtueshëm

- Ndryshimi i ligjit kërkon më pak kohë dhe burime financiare për t'u implementuar krahasuar me hartimin e një ligji të ri, duke mundësuar që zgjidhjet të hyjnë në fuqi më shpejt.
- Ndikimi legjislativ është më i vogël, pasi ndryshimet nuk prekin më shumë se 50% të dispozitave të ligjit aktual.

5. Përmirësim i strukturës dhe funksionimit të Agjencisë

- Rregullimi i kompetencave dhe përgjegjësi të Drejtorit të Përgjithshëm dhe Këshillit Mbikëqyrës do të ndihmojë në menaxhimin dhe vendimmarrjen më efektive.
- Standardizimi i proceseve dhe praktikave audituese bazuar në modelet më të mira ndërkombëtare do të kontribuojë në arritjen e objektivave institucionale në mënyrë më efektive dhe efikase.

6. Përshtatshmëri me teknikat legjislative

- Ndryshimet janë teknikisht më të thjeshta për t'u përfshirë dhe për të kaluar nëpër procedurat legjislative, duke minimizuar pengesat burokratike.

Disavantazhet:

Ndryshimet e propozuara adresojnë vetëm çështje specifike dhe nuk mundësojnë krijimin e një kuadri tërësisht të ri, i cili mund të ishte më gjithëpërfshirës për zhvillimet afatgjata.

Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve

- *Identifikoni se kush preket.*

- Identifikoni llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur; bëni dallimin midis ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.
- Për ndikimet jo të drejtpërdrejta:
 - Përshkruani nga ana cilësore ndikimet jo të drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.
 - Analizoni ndikimin mbi konkurrencën.
- Diskutoni kufizimin e analizës:
 - Jepni supozimet në të cilat janë bazuar parashikimet dhe risqet, të cilave ato u nënshtrohen.
 - Tregoni sa të forta, të pavarura dhe të rëndësishme janë provat që mbështesin supozimet.
 - Tregoni se çfarë mund të pengojë realizimin e përfitimeve, të rrisë kostot ose të sjellë pasoja të papritura.
- Përmbledhni vlerësimin e opsioneve:
 - Paraqisni një pasqyrë përmbledhëse të të gjitha ndikimeve të opsioneve të analizuara.
 - Shpjegoni se si ndikimet e të gjitha opsioneve të analizuara krahasohen me njëra-tjetrën.
 - Paraqisni përlogaritjet më të mira të përgjithshme neto të ndikimit me vlerë monetare të përcaktuar për çdo opsion (shih aneksin 1/b për tabelën që mund të përdorni).

Grupet e prekura janë:

1. Agjencia e Auditimit të Programeve të Asistencës së Akredituar (AAPAA): Si institucioni direkt i përfshirë, AAPAA preket nga ndryshimet në mënyrën e organizimit dhe ndarjes së kompetencave midis strukturave të saj, si Drejtori i Përgjithshëm dhe Këshilli Mbikëqyrës. Përcaktimi i qartë i kompetencave dhe përgjegjësi ndikon drejtpërdrejt në efikasitetin dhe funksionalitetin e Agjencisë.

2. Këshilli Mbikëqyrës i AAPAA-së: Ndryshimet në kompetencat dhe mënyrën e emërimit të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës ndikojnë te ky organ. Përcaktimi i kriterëve dhe qartësimi i rolit të Këshillit mund të ndikojnë në autoritetin dhe përgjegjësitë e tij.

3. Komisioni Evropian dhe Departamenti i Politikave të Zgjerimit (DG NEAR): Si institucione monitoruese për zbatimin e rregullave dhe standardeve të BE-së në Shqipëri, këto organe kanë interes të drejtpërdrejtë që funksionimi i Agjencisë të jetë në përputhje me marrëveshjet kuadër IPA dhe standardet ndërkombëtare. Çdo mospërputhje mund të ndikojë në raportet dhe vlerësimet e Komisionit Evropian mbi performancën e Shqipërisë në menaxhimin e fondeve IPA.

4. Grupet e interesit që përfitojnë nga fondet IPA: Edhe pse ndryshimet nuk kanë ndikim të drejtpërdrejtë te këto grupe, menaxhimi i saktë dhe auditimi efektiv i fondeve garanton që ato përdoren në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme, duke siguruar përfitimin e synuar. Grupet përfshirë OJQ-të, bizneset dhe individët që përfitojnë nga asistenca financiare e BE-së, varen nga funksionimi efikas i Agjencisë për një mbikëqyrje të saktë të fondeve.

5. Shoqëria civile dhe qytetarët shqiptarë: Në mënyrë të tërthortë, përmirësimi i funksionimit të AAPAA-së rrit transparencën dhe efikasitetin në menaxhimin e fondeve publike, çka ndikon pozitivisht në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të vendit.

6. Institucionet e tjera shtetërore: Autoritetet shtetërore që bashkëpunojnë me AAPAA-në për menaxhimin dhe auditimin e fondeve mund të ndihen të ndikuara nga ndryshimet që përmirësojnë qartësinë e rolit dhe kompetencave të Agjencisë

1. Ndikimet Sociale

Grupet e prekura që lidhen me institucionet e rregulluara nga ligji (p.sh., anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës, stafi i AAPAA-s, dhe komuniteti që përfiton nga veprimtaria e fondit IPA).

Ndikime pozitive:

Qartësi dhe drejtësi sociale: Ndryshimet në ligj mund të sigurojnë përcaktime të qarta për emërimin dhe përgjegjësitë e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës, duke përmirësuar transparencën dhe llogaridhënien.

Rritje e besimit publik: Një kuadër i përmirësuar ligjor rrit besimin e publikut te institucionet që menaxhojnë fondet dhe ndihmon në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të ofruara.

Ndikime negative:

Shumë prej aktorëve të përmendur në këtë grup mund të shohë ndryshimet si kërcënim për pozitat e tyre aktuale.

2. Ndikimet Ekonomike

Grupet e prekura: Fondet IPA, organizatat partnere, dhe përfituesit finalë të fondeve të menaxhuara nga AAPAA.

Ndikime pozitive:

Përmirësim i efikasitetit të menaxhimit të fondeve. Një ligj më i strukturuar mund të reduktojë vonesat dhe të sigurojë që fondet të auditohen në mënyrë më të drejtë dhe efektive.

Harmonizimi i kuadrit rregullator me standardet ndërkombëtare: Rregullimi ligjor mund të ndihmojë përputhjen me kërkesat e BE-së për menaxhimin e fondeve IPA, duke mundësuar më shumë financime në të ardhmen.

Ndikime negative:

Ndryshimet e mëdha ligjore mund të kërkojnë rritje të burimeve për trajnimin e stafit dhe përshtatjen me procedurat e reja.

Nëse proceset e reja janë komplekse, ato mund të krijojnë ngarkesa shtesë për përfituesit finalë.

3. Ndikimet Financiare

Grupet e prekura: Institucionet shtetërore, menaxherët e fondeve IPA, dhe donatorët.

Ndikime pozitive:

Përdorim më efektiv i buxhetit. Me procedura të rregulluara më mirë, mund të arrihet një alokim dhe shfrytëzim më i mirë i burimeve financiare.

Rritje e financimeve. Zbatimi i standardeve të larta për menaxhimin mund të rrisë mundësinë e aprovimit të projekteve të reja nga BE-ja.

Ndikime negative:

Kosto të mundshme për zbatimin e ndryshimeve. Përfshin trajnime, rishikime të proceseve dhe ndoshta shtim të burimeve njerëzore për të përmbushur kërkesat e reja.

Nga pikëpamja e ndikimit ekonomik, nisma propozuese nuk parashikohet të sjellë kosto shtesë për buxhetin e shtetit sepse ndryshimet përkatëse nuk konsistojnë në ndryshimin e strukturës organizative apo shtimin e stafit, si dhe nuk parashikon kosto shtesë për natyrën e veprimtarisë së funksioneve audituese apo funksioneve horizontale. Ky opsion parashikon vetëm rregullim ligjor të detyrave, përgjegjësi dhe kompetencave funksionale apo qartësim dhe përshtatje termash dhe konceptesh në përputhje me parashikimet ligjore.

Nga pikëpamja e ndikimit në mjedis apo ndikimit social, ky projekt ligj nuk sjell asnjë ndikim për faktin se nga këto ndryshime preket vetëm institucioni AAPAA, për mënyrën e organizimit dhe funksionit të saj, si dhe nuk ka asnjë ndikim në biznese apo shoqëri civile sepse praktika audituese procedurale rregullohen në bazë të standardeve më të mira ndërkombëtare të përcaktuara dhe parashikuara nga Komisioni Evropian.

•**Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës:** Do të përfitojnë nga përmirësimi i qartësisë ligjore mbi procedurat e tyre të emërimit dhe përgjegjësitë, duke reduktuar pasigurinë dhe konfliktet e mundshme.

•**Stafi i AAPAA-s:** Do të ndikohen nga trajnime dhe ndryshime të procedurave, duke u përballur fillimisht me vështirësi tranzitore, por duke përfituar aftësi të reja dhe stabilitet afatgjatë.

•**Fondet IPA:** Rregullimet do të përmirësojnë menaxhimin e fondeve, duke rritur ndikimin pozitiv të përfituesit finalë, por mund të krijojnë vonesa fillestare për shkak të përshtatjes me rregullat e reja.

•**Komuniteti dhe publiku:** Do të përfitojnë nga një menaxhim më i mirë i fondeve dhe rritja e transparencës, duke ndjerë një ndikim pozitiv afatgjatë në shërbime dhe projekte të financuara.

•**OJQ-të dhe organizatat e shoqërisë civile:**

•Do të përfitojnë nga procedura më të qarta dhe kritere të përmirësuara.

•**Komunitetet lokale:**

•Do të ndihen ndikime pozitive nga projektet më cilësore dhe menaxhimi më i mirë i fondeve.

Grupet e interesit që përfitojnë nga fondet IPA (Instrumenti i Ndihmës së Para-anëtarësimit) janë subjekte si institucione publike, organizata joqeveritare (OJQ), bizneset private, dhe komunitetet lokale.

Përshkrimi cilësor i ndikimeve të drejtpërdrejta:

Ndryshimet ligjore mund të sjellin përfitime të rëndësishme afatgjata për grupet e interesit që përfitojnë nga fondet IPA, duke rritur efikasitetin, transparencën dhe ndikimin e projekteve. Megjithatë, është e rëndësishme që ndryshimet të shoqërohen me mbështetje për këto grupe, për të minimizuar ndikimet negative dhe për të rritur kapacitetin e tyre për përshtatje.

Nga pikëpamja e ndikimit në mjedis apo ndikimit social, ky projekt ligj nuk sjell asnjë ndikim për faktin se nga këto ndryshime preket vetëm institucioni AAPAA, për mënyrën e organizimit dhe funksionit të saj, si dhe nuk ka asnjë ndikim në biznese apo shoqëri civile sepse praktika audituese procedurale rregullohen në bazë të standardeve më të mira ndërkombëtare të përcaktuara dhe parashikuara nga Komisioni Evropian.

Arsyetimi i opsionit të preferuar

- *Zgjidhni opsionin e preferuar, bazuar në analizë.*
- *Shpjegoni arsyetimin tuaj.*

Opsioni 3: I preferuar- Ndryshimi i ligjit ekzistues “Për Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës, Akredituar nga Bashkimi Europian, në Republikën e Shqipërisë”. Ky opsion është vlerësuar më i miri i mundshëm preferuari për arsye që arrin objektivat e parashikuara, ndryshimin e ligjit në mënyrë të tillë që do të harmonizojë ligjin e brendshëm të AAPAA-së me marrëveshjet kuadër IPA, si dhe do të jetë në përputhje me standardet e auditimit të pranuar ndërkombëtarisht.

Opsioni 3 do të sigurojë krijojë një kuadër ligjor të përshtatshëm/ efektiv dhe do të garantojë që Agjencia të ketë mandatin dhe lirinë për të kryer funksionet e saj sipas kërkesave të Marrëveshjeve Kuadër IPA duke rritur pavarësinë funksionale dhe financiare.

Ndryshimi i ligjit është një masë e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të adresuar problemet e identifikuara. Kjo do të ofrojë një kornizë të qartë dhe të mirë përcaktuar për të gjithë aktorët në sektor, duke kontribuar në një menaxhim më të mirë të fondeve të BE-së.

Një rishikim i ligjit do të forcojë kërkesat për përshtatshmëri dhe aftësi për organet drejtuese dhe funksionet kryesore të institucioneve për funksionimin efektiv të sistemeve të menaxhimit, kontrollit e të mbikëqyrjes, ligjshmërisë dhe rregullsisë së transaksioneve përkatëse të BE-së;. Kjo do të sjellë një menaxhim më të mirë dhe një vendimmarrje më efektive, duke kontribuar në përmirësimin e performancës së strukturave audituese.

Do të standardizojë funksionimin e strukturave audituese në të gjitha proceset bazuar në praktikat më të mira ndërkombëtare, duke reflektuar në realizimin dhe arritjen e objektivave institucionale në fushën e auditimit në mënyrë më efektive dhe eficiente.

Do të rregullohen konceptet dhe përkufizimet në përputhje me legjislacionin tonë të brendshëm, me strukturën organizative të AAPAA-s dhe përkufizimeve në Marrëveshjet Kuadër IPA, si dhe do të qartësohet mënyra e emërimit të Këshillit Mbikqyrës të AAPAA-s.

Do të qartësohen përkufizimet përkatëse në përputhje me strukturën organizative të AAPAA-s dhe përkufizimeve në Marrëveshjet Kuadër IPA.

Nga pikëpamja e teknikës legislative, opsioni 3 është më i përshtatshëm sepse ndryshimet nuk do të prekin më shumë se 50% të dispozitave të ligjit. Kjo do të lejojë një kalim më të shpejtë dhe më të lehtë të procesit legjislativ, duke minimizuar pengesat në zbatimin e reformave.

Ndryshimi i ligjit ekzistues kërkon më pak kohë për t'u implementuar krahasuar me hartimin e një ligji të ri. Procesi i ndryshimit zakonisht është më i shpejtë dhe më efikas, duke lejuar që zgjidhjet të hyjnë në fuqi më shpejt. Gjithashtu, ndryshimi i ligjit sjell kosto më të ulëta për sa i përket burimeve dhe financave të nevojshme për procesin legjislativ, duke e bërë atë një zgjidhje më të leverdishme për shtetin dhe institucionet e tjera të përfshira.

Në mënyrë më të detajuar ndryshimet e propozuara për këtë projektligj do të ndikojnë në:

➤ **Forcimin e strukturave audituese në kuadër të kontrollit të Fondeve të BE-s**

Projektligji i propozuar synon forcimin e strukturave audituese në kuadër të standardizimit të auditimit sipas gjetjeve dhe rekomandimeve të BE, për praktikatat më të mira audituese ndërkombëtare.

Rekomandimet dhe gjetjet e DG NEAR lidhjen me kërkesat e marrëveshjeve kuadër, marrëveshjeve të tjera sektoriale dhe/ose financuese dhe praktikatat më të mira ndërkombëtare të auditimit, duke forcuar kompetencat konkrete mbi mirëadministrimin dhe mbi procesin e vendimmarrjes në Agjenci.

➤ **Rregullimi i kompetencave dhe përgjegjësi midis Këshillit Mbikqyrës dhe Drejtorit të Përgjithshëm**

Projektili synon një ndarje të qartë të kompetencave dhe përgjegjësi ndërmjet Drejtorit të Përgjithshëm dhe Këshillit Mbikqyrës për të shmangur mbivendosje dhe konflikte në proceset e menaxhimit dhe auditimit dhe për të përmirësuar mbi efikasitetin dhe efektivitetin në mënyrën e organizimit dhe zbatimit të praktikave në Agjencisë.

Përcaktimi i qartë i kompetencave të Drejtorit të Përgjithshëm për planifikimin dhe miratimin e strategjive dhe raporteve të auditimit, si dhe roli i Këshillit Mbikqyrës, do të sigurojë funksionim më të koordinuar dhe më të përshtatshëm.

➤ **Saktësimi i disa funksioneve:**

Rishikimi dhe standardizimi i përkufizimeve dhe terminologjisë ligjore të disa funksioneve dhe termave. Disa togfjalësha dhe koncepte në ligjin aktual nuk janë në përputhje me ndryshimet e propozuara dhe standardet ndërkombëtare.

Këto ndryshime janë në përputhje dhe me përcaktimet e strukturave menaxheriale të përcaktuara në marrëveshjet kuadër IPA.

Përditësimi i kuadrit ligjor do të sigurojë konsistencë dhe përputhshmëri me legjislacionin kombëtar dhe marrëveshjet ndërkombëtare.

➤ **Forcimi i pavarësisë dhe transparencës së AAPAA-së:**

Ma anë të këtij projektligji synohet një kuadër ligjor i përshtatshëm/efektiv i cili të garantojë që Agjencia të ketë mandatin dhe lirinë për të kryer funksionet e saj sipas kërkesave të Marrëveshjes Kuadër IPA, marrëveshjeve të tjera sektoriale dhe/ose financuese duke rritur pavarësinë funksionale dhe financiare.

Përcaktimi i raportit midis detyrave dhe kompetencave të Këshillit Mbikqyrës dhe drejtorit të përgjithshëm për të azhurnuar ndryshimet përkatëse që kompetencat e auditimit të ushtrohen nga drejtori i përgjithshëm.

Marrëveshjet kuadër vënë theksin tek autonomia financiare, organizative dhe funksionale duke garantuar pavarësinë e drejtorit të përgjithshëm në përgatitjen e strategjisë së auditimit dhe hartimit të raporteve dhe opinioneve të auditimit. Drejtori i përgjithshëm i Agjencisë do të jetë shkalla më e lartë që miraton planet dhe raportet e auditimit duke respektuar kërkesat e Departamentit të Politikave të Zgjerimit në Komisionin Evropian (*DG NEAR*) mbi pavarësinë.

Në këtë mënyrë standardizimi i proceseve do të forcojë transparencën dhe besueshmërinë e Agjencisë në auditimin e fondeve të BE-së.

➤ **Qartësimi i procedurave për emërimin dhe kompetencat e Këshillit Mbikëqyrës:**

Duke qenë se ligji aktual në fuqi nuk përcakton në mënyrë të qartë kriteret dhe mënyrën e emërimit të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës, projektligji në fjalë do të arrijë të rregullojë këto aspekte, duke përcaktuar kriteret të qarta dhe mekanizma transparentë për emërimin e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës së AAPAA-s.

Për të bërë një arsyetim më të mirë për përzgjedhjen e opsionit të preferuar, kemi kryer analizën me shumë kriteret:

Për këtë arsye kemi identifikuar 6 kriteret me rëndësi për të vlerësuar:

1. Qartësimi i kompetencave dhe përgjegjësi brenda strukturës së AAPAA-së;
2. Standardizimi i funksionimit të strukturave audituese në të gjitha proceset;
3. Harmonizimi i kuadrit rregullator të AAPAA-së me marrëveshjet dhe standardet ndërkombëtare;
4. Sigurimi i një strukturë drejtuese funksionale që siguron përmbushjen e misionit dhe objektivave të AAPAA-së;
5. Forcimi i sistemit të menaxhimit dhe kontrollit të fondeve të BE-së;
6. Kosto-efektiviteti.

Secilit prej këtyre kriterëve ju është vendosur pesha përkatëse, në varësi të rëndësisë së secilit kriter, për arritjen e objektivave të përcaktuara, si më poshtë vijon:

1. Qartësimi i kompetencave dhe përgjegjësi brenda strukturës së AAPAA-së; (5)
2. Standardizimi i funksionimit të strukturave audituese në të gjitha procese; (4)
3. Harmonizimi i kuadrit rregullator të AAPAA-së me marrëveshjet dhe standardet ndërkombëtare; (5)
4. Sigurimi i një strukturë drejtuese funksionale që siguron përmbushjen e misionit dhe objektivave të AAPAA-së; (4)
5. Forcimi i sistemit të menaxhimit dhe kontrollit të fondeve të BE-së; (3)
6. Kosto-efektiviteti (5)

Këto kriterë janë vlerësuar me pikë për secilin opsion si vijon:

Kriteret	Pesha	Opsioni 0	Opsioni 1	Opsioni 2	Opsioni 3
Qartësimi i kompetencave dhe përgjegjësi brenda strukturës së AAPAA-së;	5	0 (0)	1 (5)	5 (25)	5 (25)
Standardizimi i funksionimit të strukturave audituese në të gjitha proceset	3	1 (3)	2 (6)	3 (9)	3 (9)
Harmonizimi i kuadrit rregullator të AAPAA-së me marrëveshjet dhe standardet ndërkombëtare.	4	0 (0)	0 (0)	4 (16)	4 (16)
Sigurimi i një strukturë drejtuese funksionale që siguron përmbushjen e misionit dhe objektivave të AAPAA-së;	4	0 (0)	1 (3)	3 (9)	3 (9)
Forcimi i sistemit të menaxhimit dhe kontrollit të fondeve të BE-së.	3	0 (0)	1 (3)	3 (9)	3 (9)
Kosto-efektiviteti	5	1 (5)	2 (10)	2 (10)	5 (25)
Pikët		5	27	78	93

Nga analiza e kryer, bazuar në kriteret e përmendura si më lart, duke vlerësuar secilin opsion, rezulton se opsioni 3, ka numrin më të lartë të pikëve me 93, krahasuar me opsionet e tjera.

Si rezultat, vlerësojmë se opsioni më i përshtatshëm do të jetë opsioni i 3, Ndryshimi i ligjit ekzistues 90/2016 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës, Akredituar nga Bashkimi Europian, në Republikën e Shqipërisë”.

Çështje të zbatimit

- Shpjegoni se cila njësi do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.
- Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.
- Përshkruani masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës.
- Specifikoni të gjitha kërkesat e përputhshmërisë dhe të zbatimit.

Agjencia e Auditimit të Programeve të Asistencës Akredituar nga Bashkimi Evropian (AAPAA) është institucioni përgjegjës për auditimin e sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit për veprimet, transaksionet dhe llogaritë vjetore të mbështetjes financiare të Bashkimit Evropian

Ky ligj zbatohet për veprimtarinë e auditimit për sistemet e menaxhimit dhe kontrollit për veprimet, transaksionet dhe llogaritë vjetore të mbështetjes financiare të Bashkimit Evropian.

Strukturë përgjegjëse për zbatimin e projektligjit është AAPAA me anë të drejtorive si më poshtë:

- Drejtia e Auditimit të Programeve IPA;
- Drejtoria e Auditimit të Programeve IPARD.

Strukturat përgjegjëse në AAPAA janë Drejtoria e Auditimit të Programeve IPA, Drejtoria e Auditimit të Programeve IPARD duke qenë se ndryshimet e propozuara konsistojnë në fushën e auditimit dhe këto drejtori kanë në objekt të veprimtarisë dhe dytrave funksionale të tyre auditimin e fondeve IPA dhe IPARD me qëllim verifikimin e efektivitetit dhe funksionimit të mirë të sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit të Fondeve të BE-së në Shqipëri, për përputhshmërinë me rregullat përkatëse të BE-së dhe rregullave kombëtare për të siguruar ligjshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve.

Pas miratimit të këtij projektligji parashikohet të miratohet VKM “Për Miratimin e Rregullave të Hollësishme për Veprimtarinë e Këshillit Mbikqyrës të Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës, Akredituar nga Bashkimi Evropian, në Republikën e Shqipërisë, si dhe të Procedurës për Emërimin dhe Shkarkimin e Anëtarëve të tij”, si dhe miratimi i Rregullores së Brendshme të AAPAA.

Pengesat për zbatimin e opsionit të preferuar të përzgjedhur nga AAPAA mund të jenë vonesat në miratimin e këtij projektligji;

Përveç vonesave të mundshme në miratimin e projektligjit, sfidat kryesore lidhen me koordinimin ndërinstitutional, kapacitetet teknike dhe njerëzore, rezistencën ndaj ndryshimit, dhe përputhshmërinë me standardet e BE-së. Masat për zgjidhjen e këtyre sfidave duhet të përfshijnë trajnime, bashkëpunim ndërinstitutional, dhe mekanizma të fortë monitorimi.

Mungesa e koordinimit ndërmjet strukturave përgjegjëse dhe zbatuese

Nëse shkëmbimi i të dhënave dhe koordinimi midis institucioneve të përfshira nuk është i strukturuar mirë, zbatimi mund të hasë pengesa.

Masë për zgjidhje:

Organizimi i takimeve periodike ndërinstitutionale për monitorimin e progresit.

Përcaktimi i qartë i detyrave dhe përgjegjësive të secilës strukturë përmes planeve të veprimit.

Rezistenca ndaj ndryshimit

Palët e interesuara, përfshirë stafin ekzistues, mund të jenë rezistente ndaj procedurave të reja.

Masë për zgjidhje:

Sigurimi i udhëzimeve dhe mbështetjes gjatë periudhës së tranzicionit.

Masa të tjera për zbatimin e opsionit të preferuar që parashikohen të ndërmerren janë përgatitja e dokumentave të nevojshme strategjike në kuadër të harimit të projektligjit si dhe shkëmbimi i të dhënave të nevojshme midis strukturave përkatese përgjegjëse dhe zbatuese të projektligjit në fjalë.

Faza e shqyrtimit/vlerësimit

- *Jepni një përshkrim të përmbledhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit.*
- *Identifikoni kriteret/treguesit për të matur arritjen e qëllimeve ose progresin drejt tyre.*

Ligji nr. 90/2016, "Për Organizimin dhe Funksonimin e Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës, Akredituar nga Bashkimi Europian, në Republikën e Shqipërisë," rregullon veprimtarinë e AAPAA-së dhe zbatohet për auditimin e fondeve të BE-së në territorin e Shqipërisë. Ky ligj synon të sigurojë verifikimin e efektivitetit dhe funksionimit të sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit të fondeve të BE-së, duke garantuar përputhshmërinë me rregullat përkatese të BE-së dhe ato kombëtare. Në këtë kuadër, struktura përgjegjëse do të monitorojë zbatimin e projektligjit në përputhje me të drejtat, detyrimet, përgjegjësitë dhe kërkesat e përcaktuara në ligj.

Monitorimi i zbatimit të projektligjit do të jetë i mundur nga Komisioni Evropian nëpërmjet drejtorisë DG NEAR, e cila bën periodikisht ndjekje të rekomandimeve të auditimit të lëshuara prej saj (raporti i fundit dërguar me Ref.Ares (2024)398249 - 18/01/2024), por edhe vizita të tjera verifikuese të vazhdueshme në strukturat në Shqipëri. Monitorimi do të jetë i mundur edhe nga qeveria shqiptare nëpërmjet raportimeve periodike në Kryeministri. Gjithashtu, strategjitë e auditimit dhe raportet vjetore të auditimit i dërgohen në të njëjtën kohë Komisionit Evropian dhe Këshillit të Ministrave, dhe formatet e tyre parashikojnë dhe kërkojnë edhe të dhëna mbi organizimin dhe funksionimin e autoritetit të auditimit (AAPAA-së) në përputhje me Marrëveshjet Kuadër IPA dhe standartet e auditimit të pranuar ndërkombëtarisht.

Ndryshimet ligjore do të ndikojnë pozitivisht tek strukturat përgjegjëse të AAPAA-s duke arritur objektivat institucionale në fushën e auditimit në mënyrë më efektive dhe efçente, si dhe brenda afateve proceduriale dhe ligjore të përcaktuara/ parashikuara në ligj, marrëveshjet Kuadër IPA, si dhe Strategjinë e Auditimit.

Disa prej kriterëve që do të shërbejnë për të matur arritjen e objektivave të opsionit të preferuar janë:

- Numri i rekomandimeve të implementuara nga DG NEAR.
- Rritja e numrit të auditeve të realizuara sipas praktikave më të mira ndërkombëtare.

- Përcaktimi i qartë i kompetencave dhe përgjegjësi midis Këshillit Mbikqyrës dhe Drejtorit të Përgjithshëm.
- Numri i konflikteve të raportuara për shkak të mbivendosjes së kompetencave.
- Numri i terminologjive dhe përkufizimeve të standardizuara në ligj.
- Numri i raportimeve të auditimit të miratuara nga Drejtori i Përgjithshëm.
- Përcaktimi i kriterëve dhe mekanizmave për emërimin e anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës.

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/a

Tabela: Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuara në milionë lekë e zbritur për 10 vjet (Vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në.

	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Viti 8		Viti 9	Viti 10
Faktori zbritës	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A		N/A	N/A
Kosto për buxhetin – njëhere											
Kosto për buxhetin – në vazhdim											
Kosto për biznesin – njëherë											
Kosto për biznesin – në vazhdim											
Kosto për grupet e tjera – njëherë											
Kosto për grupet e tjera – në vazhdim											
Kosto në total	-	-	-	-	-	-	-	-		-	-
Kosto e zbritur në total = Kosto në total x faktorin zbritës	-	-	-	-	-	-	-	-		-	-
Përfitimi për buxhetin – në vazhdim											
Përfitimi për biznesin – njëherë											
Përfitimi për biznesin – në vazhdim											
Përfitimi për grupet e tjera – njëherë											
Përfitimi për grupet e tjera – në vazhdim											
Përfitim për buxhetin – në vazhdim *											
Përfitimi në total	-	-	-	-	-	-	-	-		-	-
Përfitimi i zbritur në total = Përfitimi në total x faktorin zbritës	-	-	-	-	-	-	-	-		-	-
Vlera aktuale e kostos në total	-										
Vlera aktuale e përfitimit në total	-										
Vlera aktuale neto (VAN) = Vlera aktuale e	-										

përfitimit në total – Vlera aktuale e kostos në total		
---	--	--

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca2/b

- *Tabelë: Vlera aktuale neto në total e çdo opsiioni*

Opsioni	Vlera aktuale në mijë lekë		Vlera aktuale neto në mijë lekë
	Kosto	Përfitimi	
Opsioni 0	N/A	N/A	N/A
Opsioni 1	N/A	N/A	N/A
Opsioni 2	N/A	N/A	N/A
Opsioni 3	N/A	N/A	N/A